



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 27 qershor 2016**

**Numri i lëndës: 2015-07**

**Dobrivoje Radovanovic**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 27 qershor 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese

Z. Guénaël METTRAUX, anëtar

Znj. Elka FILCHEVA – ERMENKOVA, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga

Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Z. Paul LANDERS, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendor, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar me 11 qershor 2015. Për shkak të dorëheqjes së znj. Katja Dominik si anëtare e Panelit, pas shqyrtimit ajo u zëvendësua nga znj. Elka Filcheva-Ermenkova, anëtare

zëvendësuese e Panelit, në përputhje me rregullin 14 par. 2 të rregullores së punës.

## **II. FAKTET**

2. Në një datë të pasaktësuar në mars 2015, ankuesi ka blerë një lopë dhe një viç prej një G.R.. Drejt rrugës për tek shtëpia e tij, ai ishte ndaluar nga Policia e Kosovës, të cilët ia konfiskuan kafshët me dyshimin se ishin të kontrabanduara në Kosovë, pasi ato nuk kishin etiketën e nevojshme në vesh.
3. Me 5 mars 2015, Zyra Rajonale e Doganës së Kosovës në Pejë ka lëshuar një vendim dh e ka konfiskuar lopën dhe viçin pasi ankuesi nuk kishte dokumentacionin e duhur për blerjen e tyre. Ai po ashtu ishte urdhëruar të paguante një tarifë doganore dhe një gjobë me një vlerë prej gjithsej rreth një mijë e njëqind euro (1100 euro).
4. Me 19 maj 2015, Dogana e Kosovës në Prishtinë ka vërtetuar këtë vendim.
5. Nuk është e qartë nëse ankuesi ka apeluar kundër atij vendimi.

## **III. ANKESAT**

6. Pa u thirrur në ndonjë dispozitë të veçantë të dokumenteve ndërkombëtare përmblotjen e të drejtave të njeriut, ankuesi pohon se ishte dënuar padrejtësisht, në mungesë dhe pa u dëgjuar.

## **IV. LIGJJI**

7. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelin e Panelit përm Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë përmblotjen e Panelit janë Konventa Evropiane përmblotjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standartet minimale përmblotjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
8. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
9. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të

njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.

10. Paneli konstaton se nuk është argumentuar e lere më treguar se EULEX-i ka qenë i përfshirë në çfarëdo mënyre në shkeljet e supozuara të të drejtave të ankuesit. Vendimet për të cilat ai ankohet ishin lëshuar nga autoritetet e doganës së Kosovës.
11. Prandaj çështjet e ngritura nga ankuesi nuk bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë. Si pasojë ato janë jashtë mandatit të Panelit siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it Kosovë (krahaso *Shaip Gashi kundër EULEX-it*, 2013-20, 26 nëntor 2013 § 9; *Jovanka, Dragan dhe Milan Vukovic kundër EULEX-it*, nr. 2013-18, 7 prill 2014, §§ 11-12).

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës dhe

#### **SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese

